

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	611-23-12177-5-1-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Sallahu Shpk
NUI	810135237
Adresa	Rr.Baki Dullovi, Nr.158 , Biçec
Vendi	Kaçanik
Kodi postar	71000
Numri Telefonit	049745000
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Lulzim Sallahu
Adresa elektronike	nntsh_sallahu@hotmail.com
Data e parashtrimit të kërkesës	16.12.2023

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

03.11.2023 - Njoftimi per Kontrate

16.11.2023- Afati për dorëzimin e tenderëve

16.11.2023- Procesverbali i Hapjes së Tenderëve

27.11.2023- Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues

27.11.2023-Kërkesë për qasje në dokumente sipas LPP-së

29.11.2023-Takimi për qasje në dokumente sipas LPP-së

01.12.2023 - Kerkese per Rishqyrtim

04.12.2023- Vendim nga AK per aprovim kerkese dhe kthim te lendes ne rivleresim

12.12.2023 - Njoftim mbi vendimin e Autortitetit Kontraktues per anulimin e aktivitetit te prokurimit

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Procesverbali i hapjes së tenderëve është ngarkuar në platformën elektronike e-prokurim dt 16.11.2023.

Gjithësej 2 ofertues.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1- Qellimi

Neni 7- Barazia ne trajtim/jodiskriminimi

Neni 8- Planifikimi i prokurimit

Neni 9- Percaktimi i nevojave qe duhet permbushur

Neni 59-Ekzaminimi vleresimi dhe krahasimi I tendereve

Neni 62- Perfundimi i aktivitetit te prokurimit

Rregullorja nr 01/2022 per Prokurim Publik

Udhezimi nr 01/2023 per Prokurim Publik

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Kronologjia dhe rrethanat faktike :

Me date 16.11.2023 "Sallahu Shpk" ka dorezuar oferten per kete aktivitet te prokurimit ne perputhje me te gjitha kushtet dhe kriteret e vendosura ne Njoftimin per Kontrate dhe Dojsen e Tenderit .

Me date 27.11.2023 kemi pranuar Letren standard per tenderuesin e pasuksesshem, dhe Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues per rekomandim me kontrate te operatorit ekonomik "Tehnoburimi" DD .

Duke qene OE i pergjegjshem dhe palë me interes ne kuptim te nenit 4 te LPP-se , par 1.11 lidhur me paragrafin 1.26 , pas Njoftimit mbi vendimin e AK-se ,pas realizimit te qasjes ne dokumentet e OE TehnoBurimi DD kemi konstatuar se i njeiti eshte i pa pergjegjshem pasi qe nuk kishte plotesuar kushtet dhe kriteret ne Njoftimin per Kontrate dhe Dosjen e Tenderit ,ku oferta e tij ka pasur edhe mungese te theksuar te dokumentacionit.

Me date 01.12.2023 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim me të gjitha pretendimet ankimore, duke kërkuar që lënda të kthehet në Rivleresim .

Me date 04.12.2023 kemi pranuar Vendimin per Aprovim te Pjeserishem te Kerkeses per Rishqyrtim, dhe kthimin e lendes ne rivleresim nga Autoriteti Kontraktues KK Drenas.

Me date 12.12.2023 kemi pranuar Njoftim mbi vendimin e Autortietit Kontraktues per anulimin e aktivitetit te prokurimit nen arsyetimin se OE jane te papergjegjshem , ku

OE Tehnoburimi DD eliminohet per mungesa dhe mos plotesimi te nje sërë kerkesave dhe kushteve të Dosjes së Tenderit , ndersa

Sallahu Shpk pranon Letren Standard per tenderuesin e eliminuar ku thuhet :

“ OE ne fjale eshte mbi vleren e parashikuar “

Ne mbeshetjetje te provave dhe argumenteve ,konstatojme se Eliminimi yne nga procedura e prokurimit dhe Anulimi i aktivitetit te prokurimit jane ne kundërshtim me Ligjin per Prokurimin Publik dhe rregullat dytesore te prokurimit publik, per cka ne baze te fakteve te meposhtme, kerkojme nga Autoriteti Kontraktues te prishë vendimin per Anulim te procedures se prokurimit, te ktheje lenden ne rivlersim dhe te na rekomandoje me kontrate si OE I pergjegjeshëm.

Autoriteti Kontraktues ne kundërshtim me nenin 7 te LPP-se nuk ka trajtuar ne menyre te barabarte operatorët ekonomik ofertues , per faktin se edhe Oferta e OE “TehnoBurimi DD” ka qene mbi vleren e parashikuar te kontrates sipas DT , mirepo Autoriteti Kontraktues e kishte rekomanduar me kontrate dhe nuk e kishte anuluar proceduren , por kur u konstatua me Kerkesen tonë per Rishqyrtim se i njejti eshte I pa pergjegjshem dhe ka mungese te dokumenteve ne Dosjen e Tenderit , atehere vazhdon me anulim te procedures se prokurimit duke mos na rekomanduar me kontrate neve si operatorë i pergjegjshem , ku pas dy vleresimeve te tenderit eshte konstatuar se nuk kemi asnje mungese apo mos plotesim te kushteve dhe kerkesave ne Dosjen e Tenderit .

Ne perputhje me dipsoziten 9.2 & 3 te LPP-se, rezulton se eliminimi nga procedura e prokurimit eshte i kunderligjshem, per faktin se Autoriteti Kontraktues vendos se vleresimi i nevojave e arsyeton ushtrimin e aktivitetin e prokurimit duke mos eliminuar operatorët me cmim me larte se vlere e parashikuar ne Dosjen e Tenderit

:

Ne kete rast , AK nuk ka vleresuar se a ka mjete financiare/buxhet apo jo , dhe se me oferten tone a eshte tejkualuar vlera buxhetore te cilen vecse e ka te aprovuar.

Po ju ofrojme nje rast nga praktika e zbatimit te dispozitave te LPP-se ne kuader te Nenit 9 kur AK ka mjete buxhetore nuk mund te eliminoje nje OE per tejkalim te parashikimit.

Kjo per faktin se AK duhet te jape vleresimin nese vlera e e tejkualuar e ofertes tejkalon buxhetin te cilin AK e ka ne dispozicion ,e qe ne rastin konkret KK Drenas nuk e ka dhene.

Ju prezantojme Njoftimin per kontrate dhe Njoftimin per nenshkrim kontrate nga Sallahu Shpk me Autoritetin Kontraktues KK Prishtine , ku oferta e dorezuar ka qene 83,392.30 euro mbi vleren e parashikuar te ofertes me Dosjen e Tenderit ,dhe meqe AK ka pasur mjete ne dispozicion eshte vazhduar me nenshkrim kontrate.

Provë :

II.1.4) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës Ndertimi i rruges Shkendija ne Zllatar sipas pershkrimit teknik
Vlera e parashikuar e kontratës: 1 150 000,00

7/3

5/3

IV.3) Emri dhe adresa e operatorit ekonomik, me të cilin është nënshkruar kontra		
Kontrata No.: 616-21-3289-5-1-2/C792		
Grupi No.: 1		
Grupi: Ndërtimi i rrugës Shkëndija ne Zllatar		
Data e nënshkrimit te kontratës: 13.05.2022		
Numri i tenderëve te pranuar: 5		
Numri i tenderëve te përgjegjshëm: 5		
Emri zyrtar: "SALLAHU" SH.P.K.		
Adresa Postare: Rr.Baki Dullovi Nr.158		
Qyteti: Kaçanik	Kodi postar: 71000	Vendi: Kosovë
URL (nëse aplikohet):		
Personi kontaktues:		Email:
Telefoni: 044678000		Faksi:
IV.4) Informacione mbi vlerën e kontratës		
Vlera e përgjithshme e kontratës 1 233 392,30 EUR		

Sipas argumentimeve te dhena me larte , rezulton se AK ne kundërshtim me LPP-ne ne ka eliminuar nga procedura e prokurimit dhe ka anuluar tere aktivitetin e prokurimit.

Prandaj , nga cfare u prezantua me larte , bazuar ne faktet dhe argumentet mbi shkeljet ligjore te bera me rastin e vleresimit te ketij tenderi, kerkojme nga Autoriteti Kontraktues qe lenden t'a ktheje ne rivleresim, te prishë Vendimin per anulim te aktivitetit te prokurimit , dhe rivleresimi i ofertave te behet konform LPP-se dhe Rregullave dytesore te prokurimit publik.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Jane deme te konsiderueshme te cilat na jane shkaktuar, pasi qe kemi bere te gjitha pergaditjet dhe kemi kompletuar te gjitha dokumentacionin me perpikeri me qellim te realizimit te kontrates si operatore I pergjegjshe, dhe nga ky vendim jo ligjor I AK-se jemi demtuar shume edhe nga aspekti material .

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*